



K.DH.SH.II.nr.235/22

**GJYKATA KOMERCIALE** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “B....” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Parners” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1219/17, të datës 18.06.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.11.2022, merr këtë:

### **A K T V E N D I M**

**Aprovohet** si e bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal, A.nr.1219/17, të datës 18.06.2020, **Prishet** dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe rivendosje.

### **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1219/17 të datës 18.06.2020 është aprovuar kërkesëpadia e paditësit B....” ShPK me seli në Prishtinë, si e bazuar, ashtu që është anuluar aktvendimi i të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, nr.01.3.2.2/407 i datës 22.06.2017, dhe është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit “B....” Sh.p.k me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumën 2,314.77€ (dy mijë e treqind e katërbëdhjetë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent), të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e importuar përmes Deklaratës Unike Doganore R-.... të datës 12.06.2017, të Zyrës së Brendshme Doganore Merdare.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura Dogana e Kosovës, ka ushtruar ankesë për shkak të: zbatimit të gabuar të drejtës materiale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkëljes së dispozitave të procedurës LKA-së. Me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar me ligj, dhe prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë A.nr.1219/17, të datës 18.06.2020, si dhe të refuzon si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, dhe lë në fuqi vendimin e kontestuar, ose ta kthej në rivendosje.

I autorizuari i paditësit, shoqëria e avokateve “SCLR Partneres” Sh.p.k në përgjigje në ankesë e konteston në tërësi ankesën, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 81.G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar, nr.01.3.2.2/407 i datës 22.06.2017 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë "B..." Sh.p.k me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit nr.R-.... i datës 12.06.2017 të lëshuar nga ZBD Merdare, si e pa bazë.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e Doganës së Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit, nr.01.3.2.2/407 i datës 22.06.2017, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, në seancën e shqyrtimit kryesor e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin padinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke e anuluar aktvendimin e kontestuar dhe obliguar të paditurën Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit "B..." ShPK me seli në Prishtinë, t'ia kthej shumën 2,314.77€ (dy mijë e treqind e katërbëdhjetë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent), të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e importuar përmes Deklaratës Unike Doganore R-.... të datës 12.06.2017, të Zyrës së Brendshme Doganore Merdare.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi aktvendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, vendosi që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit. Me arsyetim se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara e të drejta, për faktin se gjykata nuk ka mundur të referohet në pretendimin e të paditurës se gjatë vlerësimit të mallit është bazuar në metodën e dytë të vlerësimit nga neni 34 pika 2 a) dhe në metodën e gjashtë sipas nenit 35 të KDAK-së, respektivisht në bazë të vlerës së transaksionit të mallrave identike të zhdoganuara në periudhën të afërt kohorë me mallin lëndor të njëjtë, me kodtarifor të njëjtë, emërtime të njëjtë, pra që kanë të gjitha karakteristikat e njëjta, por me vlerë më të lartë të transaksionit, dhe sipas të dhënave të disponueshme me të cilat disponon Dogana e Kosovës, e të cilat janë krahasuar me mallin lëndor, për arsye se gjykata konstaton se për të ardhur deri tek aplikimi i metodave tjera të vlerësimit nga neni 34 dhe 35 i KDAK-së, përfshirë këtu edhe metodën e dytë të vlerësimit si dhe metodën e gjashtë të vlerësimit, të aplikuar nga e paditura në këtë rast, së pari duhet të jepen arsye ligjore për mos zbatimin e metodës së parë të vlerësimit të parashikuar me nenin 33 par 1 të KDAK-së, gjë të cilën e paditura nuk e ka arritur ta bëjë. Andaj e paditura nuk ka shqyrtuar dokumentacionin e paditësit në raport me kërkesat ligjore. Krejt në fund aktgjykimin e saj e ka mbështetur në dispozitat e nenit 81I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 46 par.5 të LKA-së, dhe ka vendos si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes dhe duke i shqyrtuar vendimet e organit të paditur, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjen se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183 paragrafi 1, vërtetimin e gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike dhe zbatim i gabuar i të drejtës materiale nga neni 184 i LPK-së.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ shqyrtohet dhe vlerësohet ligjshmëria e një akti administrativ përfundimtar si në këtë rast, sipas dispozitave ligjore të LKA-së, LPK-së dhe ligjeve materiale. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkespadinë e paditësit pa e vërtetuar në tërsi gjendjen faktike të dokumentacionit përcjellës që e ka shoqëruar DUD-in R-.... dt.12.06.2017 ZBD Merdare. Kolegji vlerëson se Gjukata e shkallës së parë në këtë rast ka aprovuar këkespadinë e paditësit mbi bazën e provave të administruar në seancën gjyqësore të dt.18.06.2020. Nga këto prova të administruara nuk gjendet profatura nr.8200 në emër të së cilës është bërë pagesa bankare e datës 08.06.2017 në ..... Bank, dhe e cila provë ka qenë vendimtare me rastin e aprovimit të kërkespadiës së paditësit nga gjykata e shkallës së parë. Prandaj edhe kolegji pranon pretendimet ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë nuk ka administruar askund me profaturën e cekur më lartë.

Në ri procedurë Gjukata e shkallës së parë, duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga kolegji i kësaj gjykate, ti eliminoj të gjitha shkeljet e theksuara më lartë, të vendos në kuptim të nenit 160 të LPK-së, ashtu që ti administroj në tërsi provat e lëndës, duke ballafaquar dokumentacionin përcjellës të mallit lëndor të zhdoganuar me DUD-in R-.... dt.12.06.2017 ZBD Merdare, të ofruara nga palët ndërgjyëse, dhe të nxjerr konstatimin se a janë plotësuar kushtet ligjore për t'ia pranuar paditësit, vlerën e transaksionit konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, ashtu që dokumentacioni i mallit lëndor të jetë i harmonizuar në kuptim të vlerës me faturë, profaturë nr.8200 në bazë të së cilës është bërë pagesa e mallit kontestues, deklaratë eksportuese, konfirmimi nga eksportuesi. Varësisht nga gjendja faktike e provave të administruara, gjykata e shkallës së parë të nxjerr vendim të drejt dhe të bazuar në ligj.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 195 pika c ) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË**  
**K.DH.SH.II.nr.235/22, me datë 04.11.2022**

**Kryetare e kolegjit,**  
**Franciska Zhitija Ymeri**